

VENDIM
Nr. 551, datë 29.9.2021

PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA PROJEKTI “UNAZA LINDORE E KAVAJËS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Unaza Lindore e Kavajës”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Kavajë.

3. Pronarët të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë e llojit tokë “trual” dhe “ndërtesë me një vlerë të përgjithshme prej 15 134 372.20 (pesëmbëdhjetë milionë e njëqind e tridhjetë e katër mijë e treqind e shtatëdhjetë e dy pikë njëzet) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 15 134 372.20 (pesëmbëdhjetë milionë e njëqind e tridhjetë e katër mijë e treqind e shtatëdhjetë e dy pikë njëzet) lekësh të përballohet nga buxheti i Bashkisë Kavajë.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, do të përballohen nga buxheti i vitit 2021 të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit të jetë brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasqyruar në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin për likuidim, certifikatën e pronësisë, kartelën e pasurisë, si dhe hartën treguese të regjistrimit pranë Bashkisë Kavajë.

8. Bashkia Kavajë të kryejë procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Kavajë.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Kavajë, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Kavajë, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjnë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuar, në favor të Bashkisë Kavajë.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Kavajë, të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin që të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit, si dhe kalimi i pronësisë në favor të Bashkisë Kavajë.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Kavajë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Kavajë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyj në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

**LISTA EMËRORE E SHPRONËSIMIT TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME,
PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA PROJEKTI “UNAZA LINDORE E KAVAJËS”**

Nr.	Të dhënat mbi pasurinë sipas ASHK				Shpronësimit tokë "truall"			Ndërtesë			Vlera, total lek	Vendndodhja	Konfirmimi nga ASHK-ja
	Emri Mbiemri	ZK	Nr. pasurie	Lloji i pasurisë	Sip. e prekur m ²	Çmimi/m ²	Vlera, lek	Sip. e prekur m ²	Çmimi/m ²	Vlera lekë			
1	Hamide, Fiqret , Bujar Dimni, Zeliha Cepce, Luljeta Carlija	8551	18/361	Truall	200	7,745	1,549,000.00	111.00	26,520.20	2,943,742.20	4,492,742.20	Lagja nr. 1	Konfirmimi nga ASHK-ja
2	Emine, Galip, Ruzhdi, Xheladete Dimni, Saje Rreca, Shpresa Dylgjeri, Shahidije Marku, Jadeshe Majani	8551	18/28	Truall	154	7745	1,192,730.00				1,192,730.00	Lagja nr. 1	Konfirmimi nga ASHK-ja
3	Gezim Gjoci	8551	17/213	Truall	308	7745	2,385,460.00				2,385,460.00	Lagja nr. 1	Konfirmimi nga ASHK-ja
4	Rexhep Gjoci	8551	17/184	Truall	231	7745	1,789,095.00				1,789,095.00	Lagja nr. 1	Konfirmimi nga ASHK-ja
5	Shitet (Selim Gjoci)	8551		Truall	—	7745	-				-	Lagja nr. 1	Konfirmimi nga ASHK-ja
6	Eqerem Maliku	8551	17/110	Truall	45	7745	348,525.00				348,525.00	Lagja nr. 1	Konfirmimi nga ASHK-ja
7	Bajram Medihoxha	8551	17/109	Truall	60.8	7745	470,896.00				470,896.00	Lagja nr. 1	Konfirmimi nga ASHK-ja
8	Mynyr Maladhi	8551	17/111	Truall	50.4	7745	390,348.00				390,348.00	Lagja nr. 1	Konfirmimi nga ASHK-ja
9	Mustafa Celhaka	8551	17/106	Truall	72	7745	557,640.00				557,640.00	Lagja nr. 1	Konfirmimi nga ASHK-ja
10	Nazmi Baulja	8551	17/96	Truall	41.3	7745	319,868.50				319,868.50	Lagja nr. 1	Konfirmimi nga ASHK-ja
11	Nazmi Kuq	8551	17/53	Truall	180	7745	1,394,100.00				1,394,100.00	Lagja nr. 1	Konfirmimi nga ASHK-ja
12	Eqerem Sheshi	8551	3/199	Truall	156	7745	1,208,220.00				1,208,220.00	Lagja nr. 1	Konfirmimi nga ASHK-ja
13	Defrim Sheshi	8551	3/198	Truall	15	7745	116,175.00				116,175.00	Lagja nr. 1	Konfirmimi nga ASHK-ja
14	Vllë Tafa	8551	17/112	Truall	60.5	7745	468,572.50				468,572.50	Lagja nr. 1	Konfirmimi nga ASHK-ja
TOTAL					1574		12,190,630.00			2,943,742.20	15,134,372.20		

Shënime:

1. Vlerësimi i tokës truall është llogaritur bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”.
2. Vlerësimi i pasurisë “ndërtesë” është bërë sipas VKM-së nr.138, datë 23.3.2000, i ndryshuar.